



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:065042
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05446550

PAKR.nr.39/24

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku - kryetar, Xhevdet Abazi dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ardianë Morina, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh. B. dhe A. B. nga Drenasi, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.1, 1.5 dhe 1.11 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, ankesës të palës së dëmtuar S. M. dhe mbrojtësit të akuzuarit Xh. B, av. Haxhi Millaku si dhe përgjigjes në ankesën e prokurorisë të mbrojtësit të akuzuarit A. B., av. Agron Hoti, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.121/22 i datës 01.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, më datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, dhe e mbrojtësit të akuzuarit Xh. B, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.121/22 i datës 01.12.2023, vërtetohet.

Ankesa e të dëmtuarës S. M., përkitazi me pjesën liruese, hudhet si e palejuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.121/22 të datës 01.12.2023, e ka shpallur fajtor të akuzuarin Xh. B, për shkak të veprave penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.1, 1.5 dhe 1.11 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe për këto vepra penale, bazuar në dispozitat e nenit 76 par. 2 nën - par. 1 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim me burgim të përjetshëm në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 06.04.2021 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, dënim, ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit Xh. B, i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, ashtu që, të njëjtit i ka konfiskuar një armë të zjarrit - pushkë gjuetie, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Të akuzuarin Xh. B, e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 (njëqind) €, si dhe shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarat S. M, V. M, D. M. dhe V. M, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike i ka udhëzuar në procedurë kontestimore.

Me aktgjykimin e ankimuar të akuzuarin A. B., bazuar në dispozitat e nenit 364 par.1 nën par. 3 të KPRK-së, e ka liruar nga akuza për veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 pika 1.1, 1.5 dhe 1.11 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me arsyetim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se edhe i akuzuari A. B, ka kryer veprën penale që me aktakuzë i vihet në barrë, pra, në bashkëkryerje me të akuzuarin Xh. B.

Shpenzimet e procedurës penale, përkitazi me të akuzuarin A. B, kanë mbetur në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Prishtinë, përkitazi me pjesën liruese, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar përkitazi me të akuzuarin A. B., të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh. B, av. Haxhi Millaku, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të

kthehet në rivendosje, apo, të ndryshohet dhe i akuzuari të shpallet fajtor sipas propozimit në ankesë dhe t'i shqiptohet dënim më i butë me burgim, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë, ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit A. B, av. Agron Hoti, me propozim që ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, përkitazi me pjesën liruese të refuzohet si e pabazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për pjesën liruese të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarit S. M, V. M, D. M. dhe V. M., përfaqësuesin e autorizuar të palës së dëmtuar, av. Ndrecë Dodaj, të akuzuarit Xh. B. dhe A. B. dhe mbrojtësit e të akuzuarve, av. Haxhi Millaku dhe av. Agron Hoti. Në seancën e kolegjit prezantuan të dëmtuarit S. M. V. M. D. M. V. M. përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. Ndrecë Dodaj, i akuzuari Xh. B, mbrojtësi i të akuzuarit Xh. B, av. Haxhi Millaku dhe mbrojtësi i të akuzuarit A. B, av. Agron Hoti, ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullte nuk prezantuan Prokurori i Apelit e as i akuzuari A. B. Në seancën e kolegjit përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. Ndrecë Dodaj, pasi më parë bëri elaborimin e shkresës së dorëzuar në gjykatë, deklaroi se e përkrah ankesën e Prokurorisë Themelore dhe i propozon gjykatës që edhe të akuzuarin A. B. ta shpall fajtor dhe ta gjykojë sipas propozimit të prokurorisë, të cilën e përkrahën edhe të dëmtuarit që ishin prezent në seancën e kolegjit. Pastaj, mbrojtësi i të akuzuarit Xh. B, av. Haxhi Millaku, pasi më parë bëri elaborimin e ankesës së paraqitur kundër aktgjykimit të ankimuar, deklaroi se mbetet në tërësi pranë propozimeve si në ankesë, të cilën e përkrah edhe i akuzuari Xh. B, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit A. B, av. Agron Hoti, pasi bëri elaborimin e përgjigjes në ankesë, i propozoi gjykatës që ta refuzojë ankesën e prokurorisë, ndërsa, aktgjykimin e ankimuar përkitazi me pjesën liruese ta vërtetojë.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/L.nr.54/2024 datë 30.01.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Xh. B, av. Haxhi Millaku, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.121/22 i datës 01.12.2023, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar, përkitazi me të akuzuarin Xh. B. të vërtetohet, ndërsa, ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, përkitazi me pjesën liruese të aprovohet, ashtu që, aktgjykimi i ankimuar të anulohet për të akuzuarin A. B. dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penale-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa dhe përgjigje të ankesës, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit Xh. B, nuk janë të bazuara, ndërsa, ajo e të dëmtuarës S. M. për pjesën liruese, hudhet si e palejuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e kësaj gjykate.

Prokuroria Themelore - DKR në Prishtinë, në ankesën e sajë, përkitazi me këtë bazë ankimore, pra, për pjesën liruese, pretendon se aktgjykimin i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, kur, është liruar nga akuza e prokurorisë i akuzuari A. B. dhe

atë, sidomos, shkelje që kanë të bëjnë me dispozitivin por edhe arsyetimin, ku, dispozitivi është në kundërshtim të plotë me arsyetimin, pastaj, se arsyetimi nuk ka arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare dhe atë, sidomos, për vlerësimin e provave, ku, të gjitha provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor kanë qenë në favor të aktakuzës, ndërsa, gjykata përkundër kësaj duke dhënë vlerësim tjetër të provave në fjalë, ka nxjerrë aktgjykim lirues për të akuzuarin A. B. Në rastin konkret gjykata nuk është lëshuar fare në vërtetimin e gjendjes faktike për të akuzuarin A.B, ku, i akuzuari në fjalë, nuk ka propozuar asnjë provë në favor të tij, për arsye se i njëjti me veprimet e veta e ka kryer veprën penale e që vërtetohet sidomos, nga provat të cilat janë marrë në fazën e hetimeve, e po ashtu, janë proceduar edhe në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo, gjykata e shkallës së parë, duke i shkelur rregullat e parapara të nenit 161 par. 1 të KPRK-së, ku, thuhet “gjykata aktgjykimin e sajë e bazon në fakte dhe provat e prezantuara në shqyrtimin gjyqësor”, e njëjta, pra, gjykata e shkallës së parë, përkundër kësaj, se kemi të bëjmë, pra, me një rast ku kemi të humbur dy jetë të njerëzve, e liron të akuzuarin A. B. Më tutje, në ankesë vazhdohet me elaborimin e deklaratave të dëshmitarëve S. M, V. M, D. M, V. M, F. B, J. M. dhe S. M, pastaj, ekspertëve të mjekësisë ligjore Dr. Valon Hyseni dhe Dr. Musa Gashi si dhe të deklaratave të vetë të akuzuarve A. B. dhe Xh. B. ku, më pastaj, konstatohet se në bazë të provave në fjalë, pa mëdyshje që vërtetohet se edhe i akuzuari A. B. ka kryer veprën penale të vrasjes në bashkëkryerje me të akuzuarin Xh. B. sidomos, nëse merret parasysh fakti që dy të akuzuarit kanë kontaktuar me telefonat e tyre pak para ngjarjes kritike dhe se edhe njëri edhe tjetri, kanë poseduar dritat ditën kritike, ku, i akuzuari A. B. përmes dritës që posedonte ka kontribuar në kryerjen e veprës penale, prandaj, edhe propozon anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e çështjes në rivendosje, kuptohet, për të akuzuarin A. B.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh. B. av. Haxhi Millaku, në ankesën e tij të paraqitur kundër aktgjykimit të ankimuar, përkritazi me këtë bazë ankimore pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, me arsyetim se së pari dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyerat e aktgjykimit, në të nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare edhe ato pak arsye që janë paraqitur janë në kundërthënie të plotë ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave në lëndë. Gjithherë, sipas pretendimeve ankimore, aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 10 e lidhur me nenin 369 par. 1 të KPPRK-së, shkelje këto të cilat konsistojnë në faktin se provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk e arsyetojnë aktgjykimin në aspektin juridiko-penal, ku, arsyetimi nuk paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i konsideron të vërtetuara dhe se cilat janë arsyerat kur, konstaton se janë vërtetuar faktet në fjalë, e në mënyrë të veçantë nuk bënë vlerësimin e saktësisë së provave kundërthënëse, pastaj, nuk jep arsyerat e mosmiratimit të propozimeve të palëve, sidomos, përkritazi me cilësimin e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par.1 nën par. 1, 5 dhe 11 të KPRK-së, ku, nuk rezulton i vërtetuar as identiteti objektiv e as subjektiv i veprës penale të vrasjes së rëndë, ngase, sa i përket veprës penale të armëmbajtjes, e njëjta është pranuar fajësia nga i akuzuari që në fillim të procedurës penale, ndërsa, mbrojtja konsideron se aktgjykimi i ankimuar përkritazi me veprën penale të vrasjes së rëndë nuk mund të qëndrojë, por, mund të bëhet fjalë për vrasje të kryer nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, sikur që parashihet në dispozitat e nenit 174 të KPRK-së. Se bëhet fjalë për një kualifikim të tillë të veprës penale të vrasjes vërtetohet, përveç, të tjerave edhe nga rikonstruimi i vendit të ngjarjes, ku, të gjithë dëshmitarët V, D dhe V. M, gjatë pjesëmarrjes së tyre në rikonstruim kanë sqaruar se si i akuzuari është fyer, sharë dhe sulmuar nga dëshmitarët në fjalë dhe duke tentuar t’ia marrin armën të akuzuarit edhe ka ardhur deri tek shkrepja e armës në fjalë, nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore apo edhe në mënyrë aksidentale, pra, nën kërcënimin për t’ia marr edhe armën, ku të akuzuarit i ka shkrepur arma e cila krisëm ishte fatale për tani të ndjerin A. M, prandaj,

humbja e kontrollës ndaj të akuzuarit dhe kontrollës nga ana e të akuzuarit për jetën e tij, e shtynë që të qëllojë sërish dhe atë në drejtim të pakontrolluar dhe e godet tani të ndjerin B. M, i cili vdes pas dhjetë ditëve në spital, prandaj, edhe mund të flitet për veprë penale të lëndimit të rëndë trupor e jo sikur që ka e vendosur gjykata e shkallës së parë. Prandaj, duke i pasur parasysh ato që u thanë më lartë, është pritur nga prokuroria e shtetit që në fjalën përfundimtare ta bëjë ricilësimin e veprës penale, gjë, që nuk e ka bërë e që më pastaj, kjo është pritur edhe nga gjykata, mirëpo, e njëjta vendosi dëm të akuzuarit në kundërshtim me dispozitat e nenit 370 par. 7 dhe 8 e lidhur me nenin 384 par. 2 nën par. 1 të KPRK-së. Në rastin konkret kontraditat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve me vetë raportet e policëve, pastaj, foto dokumentacionit nga vendi i ngjarjes, e sidomos, procesverbalin nga rikonstruimi i vendit të ngjarjes është vërtetuar se vetë i akuzuari ishte sulmuar dhe kanosur, sharë dhe fyer nga dëshmitarët V. M., D. M. dhe V. M. si dhe tani i ndjeri B. M. dhe se veprimet e të akuzuarit ishin direkt nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, kur, ka shtënë në drejtim të tani të ndjerëve A. M. dhe B. M, prandaj, me vetë faktin që i akuzuari Xh. B. është shpallur fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, edhe ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për çka, edhe propozon që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit A. B. av. Agron Hoti, me pretendim se ankesa në fjalë duhet refuzuar si e pabazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar, kuptohet, për pjesën liruese të vërtetohet, me arsyetim se ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, vetëm ka konstatuar bazat ligjore për kundërshtimin e aktgjykimit, mirëpo, arsyetimi i bazave ligjore nuk qëndron, ngase, gjykata me rastin e lirit të akuzuarit ka pasur parasysh të gjitha dispozitat e procedurës penale, ku, edhe ka vërtetuar të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me faktet vendimtare në këtë çështje penalo-juridike si dhe rrethanat tjera, që mbështesin konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë, ku, edhe e ka gjetur të pafajshëm të akuzuarin A. B, për pikën I. të aktakuzës, prandaj, aktgjykimi i atakuar nga prokuroria është i pabazuar në dispozitat e KPPRK-së, e veçmas, duke marr parasysh gjendjen faktike të vërtetuar, e duke përfshirë këtu edhe elementin subjektiv të veprës penale, e që është bërë pas një analize të gjithanshme edhe me të drejtë është konstatuar se i akuzuari A. B, nuk ka kryer veprën penale, e cila me aktakuzë i vihet në barrë, prandaj, edhe propozon refuzimin e ankesës së prokurorisë, ndërsa, vërtetimin e aktgjykimit të ankimuar, kuptohet, për pjesën liruese, pra, për të akuzuarin A. B.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar dhe atë si për pjesën dënuese ashtu, edhe për pjesën liruese, për arsye se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme e të argumentuara si për pjesën dënuese dhe për pjesën liruese të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e lartë cekura ankimore janë të pabazuara, ngase, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 1 nën par. 10 e lidhur me dispozitat e nenit 369 par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, ngase, kur, është fjala për pjesën dënuese, dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin, ku janë paraqitur të gjitha arsyerat në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe përkitazi me zbatimin të caktuar të dispozitave të kodit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës penale të tij, dhe gjithashtu edhe përpilimi i dispozitivit është bërë konform dispozitave të nenit 369 par. 4 e lidhur me nenin 364 të KPPRK-së, ku, janë përfshirë të gjitha

faktet dhe rrethanat përkitazi me ngjarjen kritike, fakte dhe rrethana këto nga të cilat plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.1, 1.5 dhe 1.11 të KPRK-së, për të cilën i akuzuari Xh. B. edhe është shpallur fajtor, ndërsa, kur, është fjala përkitazi me pjesën liruese, po ashtu, gjykata e shkallës së parë, përveç, që në dispozitiv edhe në arsyetim ka përfshirë të gjitha provat nga të cilat edhe ka konstatuar se megjithatë, me provat në fjalë, duke përfshirë këtu edhe deklaratat e të dëmtuarve-dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, nuk vërtetohet se i akuzuari A. B. ka ndërmarrë çfarëdo veprimi konkret inkriminues që do të ndikonte thelbësisht në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, sikur që pretendon prokuroria në ankesë. Po ashtu, kur, është fjala për pjesën dënuese, në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, përveç, që janë përshkruar të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit, përkitazi me mënyrën se si është kryer vepra penale në fjalë, po ashtu, janë përshkruar edhe veprimet inkriminuese që përbëjnë formën cilësuese të veprës penale të vrasjes, pra, bëhet fjalë për vrasje të rëndë të kryer ndaj një të mituri, se me këtë rast përveç, që janë privuar nga jeta dy persona, po ashtu, është rrezikuar edhe jeta e personave të tjerë-pra, të dëmtuarve V. M, D. M. dhe V. M, e pastaj, janë përshkruar edhe veprimet inkriminuese të akuzuarit të ndërmarra në momentin kritik të kryerjes së veprës penale, por, edhe veprimet tjera të akuzuarit, përkitazi me motivin e kryerjes së veprës penale, por, edhe faktet dhe rrethanat që edhe i kanë paraprirë kryerjes së veprës penale, pra, nga deklaratat e dëshmitarëve por, edhe vetë të akuzuarit, vërtetohet se tek ngjarja kritike, pra, privimi nga jeta i tani të ndjerëve A. M. dhe B.M, ka ardhur kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve rreth pronësisë së malit, ku, i akuzuari ka pretenduar se tani të ndjerët A. M. dhe B. M., por, edhe të dëmtuarit V. M, D. M. dhe V. M, po merrnin drunjë në malin e të akuzuarit, kurse, të dëmtuarit së bashku me tani të ndjerët, A.M. dhe B. M, kanë konsideruar se janë duke prerë dhe marr drunjë në malin e Shtetit, arsye këto pra për të cilat edhe ka ardhur deri tek ngjarja kritike, e që në bazë të veprimeve inkriminuese të akuzuarit edhe vërtetohet se bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes së rëndë të kryer me dashje direkte nga i akuzuari Xh. B, e jo, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit se bëhet fjalë për vrasje të kryer në gjendje të afektit mendor apo edhe nga pakujdesia, apo se në rastin konkret, kur, është fjala për privimin nga jeta të tani të ndjerit B. M, mund të flitet edhe për lëndim të rëndë trupor me pasoja të vdekjes, që do të thotë se edhe në këtë drejtim, përveç, që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar edhe arsyetimi përfshin të gjitha veprimet inkriminuese që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1, 5 dhe nën par. 11 të KPRK-së, ngase, nga deklaratat e të dëmtuarve-dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, por, pjesërisht edhe vetë deklaratës së të akuzuarit, nuk rezultojnë të vërtetuara faktet dhe rrethanat përkitazi me sharje, fyerje apo edhe sulm në drejtim të akuzuarit, e që më pastaj, ky i fundit - pra i akuzuari të ketë vepruar nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, ndërsa, sa i përket të akuzuarit A. B, asnjëri nga dëshmitarët okular në vendin e ngjarjes, nuk deklaroi se i akuzuari A. B, të ketë ndërmarrë çfarëdo, veprimi inkriminues së bashku me të akuzuarin Xh. B, e që do të ndikonte thelbësisht në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë. Pra, për faktet dhe rrethanat në fjalë edhe në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsyerat e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke vepruar kështu, pra, konform dispozitave të nenit 369 par. 6 të KPPRK-së, ku, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyerat për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë, sidomos, ku në dispozitiv ka përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë mbështetje, përveç, në provat materiale në shkresat e lëndës, si procesverbali i vendit të ngjarjes, procesverbali i rikonstruimit të vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, ekspertiza mjeko-ligjore edhe në deklaratat e të akuzuarit Xh. B, kuptohet, pjesërisht, por, edhe dëshmitarëve S. M., V. M., D. M., V. M., F. B., J. M. dhe S. M., e sidomos, në deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, të dëmtuarve-dëshmitarëve V. M, D. M. dhe V. M, ku, nga dëshmitarët në fjalë, janë vërtetuar faktet dhe rrethanat përkitazi me mënyrën se si ka

ardhur deri tek kryerja e veprës penale, ku edhe njëri dhe tjetri vërtetojnë se në momentin kritik ishin duke marr drunjë nga mali, kur, papritur dëgjohej se dikush po vinte në drejtim të tyre dhe atë, me drita për ndriçim në kokë, ku, pas disa pyetjeve nga dëshmitari V. M, se “kush është” dhe një fjalosje të shkurtë në mes dëshmitarit dhe të akuzuarit Xh. B, kanë filluar të shtënat me armë, ku, i vdekur ka mbetur në vendin e ngjarjes tani i ndjeri A. M, ndërsa, pas të shtënës së dytë, lëndime të rënda trupore ka pësuar tani i ndjeri B. M., i cili pas qëndrimit disa ditësh në QKUK në Prishtinë, nga plagët e marra në vendin e ngjarjes ka vdekur, fakte këto dhe rrethana që nuk i mohon as vetë i akuzuari Xh. B, por, duke aluduar se këtë e ka bërë pasi ka qenë i kërcënuar dhe i sulmuar dhe se si pasojë edhe e konfliktit fizik nga pakujdesia ka shtënë edhe për herë të dytë, kurse, pra, sipas mbrojtjes së të akuzuarit dashja e tij nuk ka qenë që të privojë nga jeta tani të ndjerët A. M. dhe B. M, për çka, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme se përse, nuk mund të bëhet fjalë për vrasje të kryer nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, kur, i akuzuari nuk ka qenë i kanosur, por, as i sulmuar nga të dëmtuarit, por, as nga tani të ndjerët B. M. dhe A. M, por, pa mëdyshje është vërtetuar se ditën kritike i akuzuari Xh. B., ka ndërmarrë veprime konkrete inkriminuese në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Natyrisht, gjykata e shkallës së parë, një konkludim të tillë e ka aprovuar, pasi më parë ka bërë vlerësimin e provave në pajtim me dispozitat e nenit 360 par. 1 dhe 2, kurse, për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 369 par.7 të KPPRK-së, ku, përveç, deklaratës së vet të akuzuarit Xh. B, deklaratë kjo që është dhënë në polici por edhe në prokurori, ka marrë parasysh, sidomos, edhe deklaratat e të dëmtuarve - dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes V. M, D. M. dhe V. M, dëshmitarë këta të cilët kanë deklaruar, se pas një bisede të shkurtë në mes të akuzuarit Xh. B. dhe të dëmtuarit V. M., ka ardhur deri tek të shtënat, ku, i akuzuari menjëherë ka shtënë me armë zjarri - të gjuetisë, që e kishte me veti, ku, së pari ka qëlluar tani të ndjerin A. M., e më pastaj, ka shtënë edhe për herë të dytë, ku, e ka qëlluar tani të ndjerin B. M., e që faktet dhe rrethanat në fjalë, pastaj, janë vërtetuar edhe nga dy dëshmitarët-të dëmtuarit tjerë, D. M. dhe V. M., e që të njëjtat deklarata kanë mbështetje edhe në provat materiale në shkresa të lëndës, si ekspertiza mjeko-ligjore, ekspertiza e AKF-së, përkitazi me gëzhhojat e gjetura në vendin e ngjarjes, deklaratat e ekspertëve të mjekësisë ligjore, Dr. Valon Hyseni dhe Dr. Musa Gashi, procesverbali i rikonstruimit të vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë, ku, është vërtetuar se plagët e shkaktuara tek tani të ndjerët kanë qenë të shkaktuara me armën e zjarrit - gjuetisë, të tani të akuzuarit, e që është vërtetuar edhe përmes gëzhhojës së gjetur në vendin e ngjarjes, e cila i ka takuar armës së gjuetisë së të akuzuarit, pastaj, nga vetë forma e plagëve të shkaktuara tek tani të ndjerët, e duke marr parasysh karakteristikat për plagët që shkaktohen nga armët e gjuetisë, është vërtetuar se të njëjtat janë shkaktuar me armën e gjuetisë të akuzuarit Xh. B., fakte këto dhe rrethana që nuk i ka kontestuar as vetë i akuzuari, por, duke pretenduar se ka qenë i sulmuar, prandaj, edhe ka shtënë në drejtim të tyre, për çka, përkitazi me pretendimet në fjalë gjykata e shkallës së parë, është deklaruar mjaftueshëm në arsyetimin e sajë, pra, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë kështu vlerësimin e provave kontradiktore, pra, ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, përveç, në dispozitiv që ka përfshirë të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit që kanë të bëjnë me mënyrën se si ka ardhur tek kryerja e veprës penale edhe në arsyetim ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe atë duke u mbështetur, përveç, në deklaratat e të dëmtuarëve - dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes V. M., D. M. dhe V. M., pastaj, vetë deklaratën e të akuzuarit, ka marr parasysh edhe provat materiale, që do të thotë se me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, se bëhet fjalë për vrasje të rëndë, e të kryer me dashje direkte e jo sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, se vepra penale në fjalë, është kryer nën ndikimin e tronditjes

së fortë mendore, nga i akuzuari Xh. B., për çka, pra, në këtë drejtim, përkitazi me atë se përse ka konkluduar se pikërisht i akuzuari Xh. B., është personi që ka privuar nga jeta tani të ndjerët A. M. dhe B. M., gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve vendimtare në këtë çështje penale juridike, duke konstatuar, njëkohësisht, se nuk mund të vërtetohet se i akuzuari A. B., në çfarëdo, mënyre ka kontribuar në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari Xh. B., ngase, kur, është fjala për dritat, që pretendohet se të dëmtuarit kanë vërejtur dy drita, asnjëri e as tjetri nuk vërtetojnë se çka, konkretisht ndërmori i akuzuari A. B., që të konsiderohet si kontribut thelbësor në kryerjen e veprës penale me të akuzuarin Xh. B., ngase, drita në kokë kishte edhe vetë i akuzuari Xh. B., prandaj, edhe nuk ka pasur nevojë për dritën e të akuzuarit A. B., i cili po ashtu, supozohet ta ketë pasur dritën në kokë, ndërsa, sa i përket bisedave telefonike, përveç, që pretendohet se kanë biseduar dy të akuzuarit në mes veti, me asnjë provë në shkresat e lëndës nuk vërtetohet përmbajtja e bisedave në fjalë, prandaj, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë është deklaruar në mënyrë të detajuar në arsyetimin e sajë, konkludime këto të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë, që do të thotë se me asnjë provë në shkresa të lëndës nuk është vërtetuar se i akuzuari A. B., të ketë ndërmarrë ndonjë veprim inkriminues në drejtim të kryerjes së veprës penale të vrasjes së rëndë, në bashkëkryerje me të akuzuarin Xh. B..

Prandaj, përveç, që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur i dyshimtë ose i pavërtetuar dhe përveç, që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu, edhe për mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga i akuzuari, ku, përkitazi, me faktet dhe rrethanat në fjale, se pari ka marrë parasysht deklaratat e vetë të akuzuarit Xh. B., i cili në mbrojtjen e tij, në deklaratën e dhënë në polici dhe prokurori, nuk e ka mohuar kryerjen e veprës penale, gjegjësisht, se ka privuar nga jeta tani të ndjerët A. M. dhe B. M., por, duke u arsyetuar se këtë e ka bërë si pasojë e provokimeve që ka pasur nga tani i ndjeri B. M., por, edhe dëshmitari V. M., ku, si pasojë e sharjeve, fyerjeve e sulmit edhe ka shtënë me armën e tij të gjuetisë duke e goditur kështu së pari tani të ndjerin A. M., e më pastaj, pasi i dëmtuari V. M. tenton t'ia marrë armën ka shtënë sërish me armën e tij duke e goditur tani të ndjerin B. M., duke pretenduar, pra, kështu se në rastin e parë ka vepruar nën ndikimin të tronditjes së fortë mendore, kurse, në rastin e dytë nga pakujdesia, pretendime këto të cilat me të drejtë gjykata e shkallës së parë, nuk i ka aprovuar, ngase, të njëjtat nuk kanë mbështetje në asnjërin nga provat materiale në shkresa të lëndës, e as në deklaratat e të dëmtuarve-dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, ku, të gjithë këta, pra, dëshmitarët okular në vendin e ngjarjes, kanë deklaruar se pasi kanë vërejtur se dikush po vinte në drejtim të tyre, i dëmtuari-dëshmitari V. M., ka shkuar në drejtim të tij, pra, për të biseduar, ku, pas një fjalosje të shkurtë me të akuzuarin Xh. B., i njëjti, pra, i akuzuari Xh. B., ka shtënë me armë zjarri - të gjuetisë, ku, edhe ka goditur tani të ndjerin A. M., pastaj, ka shtënë për herë të dytë, ku, e ka goditur tani të ndjerin B. M., e që faktet dhe rrethanat në fjalë i vërtetojnë edhe dëshmitarët tjerë V. M. dhe D. M., por, që të njëjtat kanë mbështetje po ashtu, në provat materiale në shkresa të lëndës, si ekspertizën mjeko-ligjore, pastaj, atë të AFK-së në Prishtinë, ku, vërtetohet se palët e shkaktuara tek tani të tjerët A. M. dhe B. M., janë shkaktuar nga arma e gjuetisë, gjë, që, është vërtetuar edhe nga gëzhoja e gjetur në vendin e ngjarjes, e që është vërtetuar se bëhet fjalë për armën e gjuetisë tani të akuzuarit Xh. B., pra, është vërtetuar se dy tani të ndjerit A. M. dhe B. M., janë privuar nga jeta me armën e gjuetisë të akuzuarit Xh. B., dhe atë pas një fjalosje të shkurtë në mes të dëmtuarit V. M. dhe të akuzuarit Xh. B., që do të thotë se asnjëri nga dëshmitarët nuk vërteton se i akuzuari tjetër, pra, i akuzuari A. B., të ketë ndërmarrë çfarëdo, veprimi inkriminues në drejtim të veprës penale të vrasjes së rëndë, sikur që pretendon prokuroria, për çka, gjykata e shkallës së parë, edhe e ka liruar nga akuza e prokurorisë.

Prandaj, në bazë të cekurave si më lartë, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 e lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, sikur që pretendohet në ankesat e prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit Xh. B., av. Haxhi Millaku.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal si dhe gjetjet e kësaj gjykate.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike me ankesa në esencë vetëm janë përsëritur pretendimet e njëjta ankimore të cekura tek baza ankimore shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, ku, në esencë, kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, e sidomos, kur merret parasysh se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se vepra penale në fjalë, sipas prokurorisë është kryer së bashku nga dy të akuzuarit Xh. B. dhe A. B., pra, në bashkëkryerje, me arsyetim se edhe i akuzuari A. B. ishte në vendin e ngjarjes dhe se me dritën e tij në kokë, ka kontribuar thelbësisht në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari Xh. B., ndërsa, sipas mbrojtësit të akuzuarit Xh. B., av. Haxhi Millaku, në bazë të gjitha provave dhe shkresave tjera në lëndë, vërtetohet se i akuzuari Xh. B., veprën penale të vrasjes e ka kryer nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, prandaj, me vetë faktin që gjykata e shkallës së parë, e ka shpallë fajtor të akuzuarin, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit Xh. B., ndërsa, sipas prokurorisë është bërë shkelje e ligjit penal në favor të akuzuarit A. B., kur, të njëjtin e ka liruar nga akuza, për çka, edhe propozon që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rivendosje, sipas prokurorisë, ndërsa, sipas mbrojtësit të akuzuarit të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe i akuzuari Xh. B. të shpallet fajtor sipas propozimit në ankesë.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, në këtë çështje penalo-juridike gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka vërtetuar se ditën kritike, pas një fjalosje të shkurtë në mes të dëmtuarit - dëshmitarit V. M. dhe të akuzuarit Xh. B., në malin ku, po prenin dhe bartnin drunjë, pra, tani të ndjerët A. M. dhe B. M. dhe të dëmtuarit V. M., D. M. dhe V. M., i akuzuari ka shtënë me armë zjarri-armë të gjuetisë, ku, herën e parë e ka goditur tani të ndjerin A. M., duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore të përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ku, si pasojë e tyre tani i ndjeri vdes në vendin e ngjarjes, pastaj, ka shtënë serish me armën e tij të gjuetisë në drejtim të tani të ndjerit B. M., ku, si pasojë e lëndimeve të rënda trupore, të përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, pas qëndrimit disa ditë në QKUK, në Prishtinë, si pasojë e lëndimeve të marra në fjalë nga i akuzuari, ka vdekur në lokalet e QKUK-së në Prishtinë. Po ashtu, nga deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes vërtetohet se gjatë të shtënave në drejtim të tani të ndjerëve A. M. dhe B. M., i akuzuari ka rrezikuar edhe jetën e të dëmtuarve V. M., D. M. dhe V. M., ngase, të njëjtit ishin në afërsi të akuzuarit në momentin e të shtënave dhe atë në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerëve A. M. dhe B. M. dhe atë të gjithë këta në një afërsi me të akuzuarin nga 5-6 metra, fakte këto dhe rrethana që vërtetohen nga deklaratat e të dëmtuarve-dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes V. M., D.M. dhe V. M., pastaj, pjesërisht i ka vërtetur vetë i akuzuari Xh. B., e që të njëjtat fakte dhe rrethana kanë mbështetje edhe në provat materiale në shkresa të lëndës, si raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, raporti i autopsisë, ekspertiza mjeko-ligjore, raporti i ekzaminimit të armës nga AKF-ja, raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera

në lëndë, për çka, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se pa dyshim se vërtetohet se i akuzuari Xh. B., me dashje direkte ka privuar nga jeta tani të ndjerët A. M. dhe B. M., e duke rrezikuar kështu, njëkohësisht edhe jetën e të dëmtuarve, V. M., D. M. dhe V. M.. Gjithashtu, në bazë të një gjendje të tillë faktike, gjykata e shkallës së parë, ka konkluduar se nuk mund të bëhet fjalë për vrasje të kryer nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, por, as aksidentale, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit dhe njëkohësisht ka konstatuar se për të akuzuarin A. B., nuk mund të vërtetohet se i akuzuari në fjalë, në çfarëdo mënyre ka kontribuar në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari Xh. B., e që do të mund të flitej për bashkëkryerje, për çka, edhe e ka liruar të akuzuari A. B. nga akuza e prokurorisë.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura, si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari Xh. B., është kryerësi i veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1, 5 dhe 11 të KPRK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor dhe është gjykuar, ndërsa për të akuzuarin A. B., ka konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk mund të vërtetohet se i akuzuari A. B. ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 1, 5 dhe 11 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, sikur që pretendon mbrojtja e të akuzuarit, kur i akuzuari Xh. B., është shpallur fajtor dhe është gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, gjegjësisht, në favor të akuzuarit A. B., kur, i njëjti është liruar nga akuza e prokurorisë.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit Xh. B., nuk janë të bazuara.

Në ankesën e të mbrojtësit të akuzuarit Xh. B., av. Haxhi Millaku, përkitazi me këtë bazë ankimore, për të akuzuarin Xh. B., pretendon se gjykata e shkallës së parë, ka shqiptuar dënim të ashpër, ngase, dënimi është i lartë, me arsyetim se i njëjti nuk është në proporcion me veprimet inkriminuese të akuzuarit dhe se një dënim i tillë i rëndë nuk mund të krijojë efekte sikur që kërkohet tek qëllimi i sanksioneve penale, pastaj, se dënimi i tillë nuk përkon po ashtu, as me praktikën gjyqësore, sidomos, ku, nuk janë marr parasysh edhe rrethanat lehtësuese, se i akuzuari është mbajtës i familjes, i moshës relativisht të vjetër, nuk ka qenë i dënuar më parë, për çka, edhe propozon ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të rikualifikimit të veprës penale, e më pastaj, edhe shqiptimin e një dënimi më të butë për të akuzuarin Xh. B..

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara e në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit, për veprat e kryera penale e në të cilat thirren në arsyetimin e aktgjykimit dhe duke i vlerësuar të njëjtat përkitazi me pretendimet ankimore, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit Xh. B., se dënimi është i ashpër.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe atë konform dispozitave të

nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ku, si rrethana rënduese, përveç, shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallë së përgjegjësisë penale të akuzuarit, ka marr shkallën e lartë të dashjes, pra vendosmërinë për kryerjen e veprës penale, moshën e njërit nga viktimat, pra, bëhet fjalë për tani të ndjerin A. M., i cili ka qenë vetëm i moshës 15 vjeçare, ngase, nuk është njësojë sikur të ishte 16, 17 apo edhe nën moshën 18 vjeçare, sikur që në rastin konkret, pra, ka qenë i moshës 15 vjeçare, pastaj, se familja e dëmtuar-pra, nëna, përveç, që ka humbur bashkëshortin e sajë, tani të ndjerin B. M., po ashtu, ka humbur edhe fëmijën dhe në prezencën e rrethanave në fjalë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv, që do të thotë, se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit nuk qëndrojnë, ngase, mbrojtësi i të akuzuarit Xh. B., edhe ashtu, në ankesë ka cekur disa nga rrethanat lehtësuese, që në raport me rrethanat rënduese, e sidomos, mënyrën e kryerjes së veprës penale por, edhe motivin e kryerjes së veprës penale janë irelevante, sidomos, kur merret parasysh koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale, pra, bëhet fjalë për orët e mbrëmjes-pra, ishte terr, e që për të dëmtuarit dhe tani të ndjerit ka qenë edhe e befasishme dhe e frikshme, pastaj, vendin, ku, të ndjerët dhe të dëmtuarit kishin shkuar në mal, për të prerë dhe marr drunjë për nxemje, për familjen e tyre, pastaj, se e vetmja arsye për të privuar nga jeta tani të ndjerët, ishte pretendimi i të akuzuarit se të njëjtit po merrnin drunjë në malin e të akuzuarit, pastaj, në rastin konkret bëhet fjalë për tri forma kualifikuese të vrasjes së rëndë, pra, nuk është njësojë sikur të kryhet një vrasje e rëndë për shkak të një forme kualifikuese sikur për shkak të tri formave kualifikuese të vrasjes së rëndë, si në rastin konkret, prandaj, kjo gjykatë, duke marr parasysh rrethanat rënduese të cekura si më lartë, konsideron se dënimi të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se, i njëjti është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës të kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, pati parasysh edhe ankesën e palës së dëmtuar S. M., përkitazi me pjesën liruese, mirëpo, bazuar në dispozitat e nenit 381 par. 3 të KPPK-së, të njëjtën e hudhi si të palejuar, ngase, me dispozitat në fjalë parashihet se i dëmtuari mund të paraqesë ankesë ndaj aktgjykimit dhe atë vetëm për vendimin e gjykatës, lidhur me sanksionet penale dhe atë për veprat penale që përfshihen në kapitujtë kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual dhe kundër sigurisë së trafikut publik si dhe tek vendimet mbi shpenzimet e procedurës penale, pra, jo edhe për bazat tjera ankimore apo edhe për rastet kur kemi të bëjmë me aktgjykim lirues, prandaj, Gjykata e Apelit, e hudhi ankesën e palës së dëmtuar, përkitazi me pjesën liruese për të akuzuarin A. B., si të palejuar.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS **PAKR.nr.39/2024, më 01.03.2024**

Procesmbajtëse,
Ardianë Morina

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,
Hashim Collaku

1.Xhevdet Abazi

2. Zyhdi Haziri

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqitet nga palët në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës, përmes, gjykatës së shkallës së parë, për pjesën dënuese, ndërsa, për pjesën liruese ankesa është e palejueshme.